



USHTRIA



Viti i 74-të i botimit Nr. 34 (827732)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 20 Gusht 2021

Teknikat bazë dhe koordinimi me strukturat e përfshira në operacion



Trajnimi i efektivave për shuarje zjarri nga ekspertët e USAID

Në kuadër të operacioneve për shuarjen e zjarreve, në datën 16 gusht 2021 në mjediset e Repartit Ushtarak 1010, Vau i Dejës, Shkodër me personel komandues të këtij reparti, u zhvillua trajnim nga ekspertët të Byrosë për Ndihmë Humanitare të USAID dhe specialistë të Agjencisë Kombëtare të Mbro-

jtjes Civile në përgjigje të situatës së zjarreve në vend. Qëllimi i këtij trajnimi ishte shpjegimi i teknikave bazë të luftës ndaj zjarreve, si dhe koordinimi me strukturat e tjera të përfshira në këto operacione. Në vijimësi ekspertët e USAID do të zhvillojnë edhe trajnime të tjera në këtë fushë. >>> faqe 2

Sfidat, vështirësitë, përgjegjësitë dhe triumfi i ëndrrës

Intervistë me dy mjeket e reja ushtarake, nëntoger Dajana Zenelaj dhe Hygerta Ilmca



>>> faqe 8

Situata e zjarreve

Ministri Peleshi falenderon BE dhe vendet anëtare për mbështetjen

Mekanizmi i Mbrojtjes Civile të BE-së, thelbësor në përballimin e situatës së zjarreve >>> faqe 3



Zjarri në malin e Tërbunit në Pukë

U angazhuan 50 efektivë të FA, 12 zjarrfikës, 8 punonjës të shërbimit pyjor, 20 vullnetarë

Zjarri në malin e Tërbunit në Pukë, vazhdoi të ishte problematik edhe në datën 16 gusht 2021. 50 efektivë të FA, 12 zjarrfikës, 8 punonjës të shërbimit pyjor, 20 vullnetarë punuan për mbajtjen në kontroll të situatës që të mos rrezikohet kurora e qytetit të Pukës. Në fshatin Fletë, në Fushë - Arrëz situata u vu në kontroll ndërsa në fshatin Dardhë situata paraqetj më problematike për shkak të bimësisë së dendur. Ishte...



>>> faqe 3

Situata

Zjarret, angazhohen në terren forca të FA dhe forca të bashkive

Edhe në 17 gusht 2021, situata e zjarreve në vend, vijoi të ishte aktive në disa vatra sidomos në pjesën veriore. Megjithatë situata e zjarreve në vend, u paraqit si më poshtë: Qarku Shkodër: Mali i Tërbunit, bashkia Pukë, zjarri vazhdoi të ishte aktiv në pjesën veriore dhe në pjesën lindore në Fushë - Kumulli. Në terren u angazhuan 40 forca të FA, 60 forca të bashkisë. Helikopteri holandez ka... >>> faqe 4



Jens Stoltenberg në konferencën për shtyp, 17 gusht 2021

Afganistani i sotëm është shumë i ndryshëm nga Afganistani i vitit 2001

>>> faqe 10

OPERACIONET NGA AJRI

Helikopteri Cougar hodhi rreth njëqind mijë litra ujë në zonën e operimit

faqe 6

HISTORI

Udhëtim në kohë i familjes Binaj

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ >>> faqe 9

Teknikat bazë dhe koordinimi me strukturat e përfshira në operacion

Trajnimi i efektivave për shuarje zjarri nga ekspertët e USAID

Në kuadër të operacioneve për shuarjen e zjarreve, në datën 16 gusht 2021 në mjediset e Repartit Ushtarak 1010, Vau i Dejës, Shkodër me personel komandues të këtij reparti, u zhvillua trajnim nga ekspertë të Byrosë për Ndihmë Humanitare të USAID dhe specialistë të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile në përgjigje të situatës së zjarreve në vend.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte shpjegimi i teknikave bazë të luftës ndaj zjarreve, si dhe koordinimi me strukturat e tjera të përfshira në këto operacione.

Në vijimësi ekspertët e USAID do të zhvillojnë edhe trajnime të tjera në këtë fushë.



FA dhe zjarrfikësit lokalë vunë nën kontroll zjarrin në Malin e Rrjacës

Mbi 100 forca në 2 vatra në Thirrë dhe Katund i Vjetër në Mirditë, rreth 200 forca në malin e Tërbunit në Pukë dhe Dardhë në Fushë-Arrëz



Forcat e Armatosura dhe zjarrfikësit lokalë vunë nën kontroll zjarrin në Malin e Rrjacës në Prrenjas, në 18 gusht 2021, por puna vijoi pasi era mund ta favorizonte duke rrezikuar Parkun Kombëtar të Shebenik-Jabllanicës në kufi me Maqedoninë e Veriut, ku edhe fqinjët tanë po punojnë në pjesën e tyre. Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi tha se “mbi 100 forca po luftojnë me flakët në 2 vatra të ndryshme në fshatrat Thirrë dhe Katund i Vjetër në Mirditë, ku tymi i dendur ka vështirësuar ndërhyrjen nga ajri dhe era favorizon flakët. Në malin e Tërbunit në Pukë dhe fshatin Dardhë në Fushë-Arrëz era dhe terreni po favorizojnë përhapjen e zjarrit, ndërkohë që në këto 2 vatra po punojnë aktualisht në terren rreth 200 forca.”, tha ministri Peleshi. Vatrata e tjera në vend në datën 18 nuk paraqitën rrezik të lartë dhe ndërkohë vijoi puna e autoriteteve lokale për shuarjen e tyre. Situata e vatrave të zjarrit në Republikën e Shqipërisë, ishte si më poshtë:

Qarku Lezhë: Raportohet se në Bashkinë Mirditë, njësi administrative Fan, fshati Thirrë, në zonë ka shumë tym dhe si pasojë vështirësohet kryerja e operacioneve efektive nga ajri. Situata momentalisht nuk është problematike, por rritja e temperaturës dhe erës mund të bëjë që situata të dalë jashtë kontrollit. Për fikjen e zjarrit janë angazhuar 40 efektivë të FA dhe rreth 30 nga autoritetet lokale. Në Bashkinë Mirditë, njësi administrative Rubik, fshati Katund i vjetër, Forcat e Armatosura po punojnë në terren, pasi përshkallëzimi i vatrës së zjarrit paraqet rrezik për banesat pranë. Në Bashkinë Mirditë, njësi administrative Fan, fshatrat Munellë dhe Domgjon, aktualisht vatra nuk paraqet rrezik dhe po monitorohet në terren. Bashkia Lezhë, njësi administrative Kolsh, fshati Patalej, vatra e zjarrit është izoluar në masën

95%. Situata është e qetë dhe në terren janë forcat e pushtetit vendor.

Qarku Shkodër, raportohet se Bashkia Pukë, Mali i Tërbunit: në Qafë - Kummulli fryn erë dhe flakët favorizohen nga barishtet e ulëta dhe të thata. Në operacionet e shuarjes së zjarrit janë angazhuar 42 trupa të FA, dhe rreth 30 nga autoritetet lokale, përfshirë vullnetarë.

Bashkia Fushë - Arrëz, njësi administrative Blerim, fshati Flet: vatra e zjarrit që ka prekur fshatin Kryezi është izoluar

dhe po punohet për shuarjen totale të saj. Ndërsa nga ana e fshatit Dardhë situata është më e ndërlikuar për shkak të terrenit të vështirë. Zjarri ka kaluar pjesën e zhveshur të luginës dhe është në drejtim të kurorës me pisha dhe bredh. Në këtë krah po punojnë 40 forca të FA dhe 35 forca nga pushteti vendor dhe shërbimi pyjor.

Bashkia Shkodër, njësi administrative Gur i Zi, fshati Gur i Zi: vatra aktualisht është izoluar pasi efektivë nga Forca Tokësore kanë krijuar breza

ndarës. Situata po mbahet nën kontroll pasi një rritje e shpejtësisë së erës mund të sjellë përkeqësim të situatës.

Qarku Kukës: Bashkia Kukës, Maja e Rrunës - Zjarri është aktiv prej 14 ditësh dhe është në drejtim të fshatit Shënmri. Për normalizimin e situatës është angazhuar dhe helikopteri holandez. 40 trupa nga FA, pushteti lokal dhe vullnetarë po punojnë në terren për shuarjen e flakëve. Bashkia Has, njësi administrative Golaj, fshati Nikshiq: autoritetet

lokale janë në terren duke shuar flakët.

Qarku Elbasan: Bashkia Prrenjas, mali i Rrajcës: vatra e zjarrit ndodhet në pjesën lindore të fshatit Skënderbej dhe ka nga një terren shkëmbor me pyll dushku dhe dëllënjë. Falë punës së forcave tokësore aktualisht është mundësuar normalizimi i situatës. Kjo vatrë ka një rëndësi kritike pasi përhapja e perimetrit të saj rrezikon parkun kombëtar Shebenik - Jabllanicë. Zjarri është në kufi me Maqedoninë e Veriut ku gjithashtu po punohet në anën që ka prekur territorin e tyre. Në operacionet e shuarjes së zjarrit janë angazhuar 20 forca të FA dhe zjarrfikësit e Prrenjasit dhe Elbasanit.

Bashkia Peqin: është aktivizuar zjarri në një vendgrumbullim mbeturinash. Vatra nuk paraqet rrezik por shkakton ndotje të ajrit. Për operacionet e shuarjes së zjarrit janë angazhuar 1 mjet i FA dhe 1 fadromë.

Qarku Dibër: Bashkia Dibër, njësi administrative Selishtë, Qafë - Murrë, Kacni: në zonë janë dy vatra zjarri në të cilat intensiteti është i ndryshëm. Në vatrën në anën e Baxhaj, Gura e Vorbullës (Qafë - Murrë) situata është vënë nën kontroll dhe nuk ka rrezik. Nga ana e fshatit Kacni ku është përqendruar dhe angazhimi më i madh i forcave zjarri vazhdon të jetë aktiv duke zgjeruar perimetrit në barëra të thata. Terreni është shkëmbor dhe i vështirë për ndërhyrjen e forcave nga toka. Rreziku që paraqitet është kalimi i zjarrit në kurorën e pishave. Për shuarjen e zjarrit janë angazhuar 15 forca të FA dhe 23 forca nga strukturat e pushtetit vendor.

Qarku Gjirokastrë: Bashkia Memaliaj, njësi administrative Krahëz, fshati Allkomenaj: deri më tani vatra e zjarrit nuk është problematike. Në terren ka pyll me pisha. Në operacionet e shuarjes së zjarrit janë angazhuar zjarrfikësit lokalë.

STAFI

MIMOZA GOLIKJA

Shef i Sektorit të Botimeve & Kryeredaktor
në mungesë dhe me urdhër

Gazetarë:

Hajrie DEDAJ

Redaktore/ korrektore:

Suela HODA

Graphic Designer:

Afërdita HYSAJ

ADRESA:

Rruga e Dibrës/
Garnizoni "Skënderbej"

Situata e zjarreve

Ministri Peleshi falenderon BE dhe vendet anëtare për mbështetjen

Mekanizmi i Mbrojtjes Civile të BE-së, thelbësor në përballimin e situatës së zjarreve

Mbështetja e Mbretërisë së Holandës dhe Republikës Çeke nëpërmjet Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të BE ka rezultuar thelbësore në përballimin e situatës së zjarreve të krijuar në vendin tonë gjatë muajit gusht.

Në një aktivitet të organizuar në pjesën ushtarake të Aeroportit Ndërkombëtar "Nënë Tereza", në 17 gusht 2021, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi e nisi fjalën e tij duke shprehur ngushëllimet për humbjen e dy jetëve, të cilat i konsideroi të pazëvendësueshme.

Në prani të kreut të Seksionit Politik të Delegacionit të BE në Tiranë Alexis Hupin, ambasadorit të Republikës Çeke Jaroslav Ludva, zëvendësambasadorit holandez Rogier Nouwen, ministri Peleshi falënderoi qeveritë e këtyre vendeve për ndihmën e dhënë dhe ofroi një panoramë për gjendjen e përgjithshme gjatë kësaj periudhe.

"Pavarësisht se jemi në mes të punës, e çmoj shumë të rëndësishme që mirënjohjen tonë ta ndajmë me publikun për ata partnerë që na janë gjendur në një kohë shumë të shkurtër nga koha që iu drejtuan Mekanizmit Evropian të Mbrojtjes Civile. Kështu, dua të falënderoj BE dhe mekanizmat e tij, Zyrën e Delegacionit të BE në Tiranë për një përgjigje të shpejtë në ndihmë të Shqipërisë për të përballuar këtë situatë të pazakontë të zjarreve që ka përfshirë rajonin tonë. Jemi ende në mes të emergjencave të zjarreve sidomos në pjesën e veriut të Shqipërisë. Tashmë mund të themi se kemi disa arritje të rëndësishme, disa suksese për të shpëtuar parqe, fshatra dhe mbi të



gjitha jetë njerëzish. Kemi shpëtuar me sukses Parkun Kombëtar të Llogorasë, një nga mushkëritë më të rëndësishme të vendit, por sot jemi ende në mes të shumë vatrave të zjarrit në pjesën e veriut, kryesisht në qarkun e Kukësit, Lezhës dhe të Shkodrës, pra në bashkinë

e Pukës, Mirditës, Kukësit kemi ende vatra. Llogarisim 3 mijë hektarë dëmin e deritanishëm në sipërfaqe të gjelbra. Është një shifër e konsiderueshme, por lajmi i mirë është se pjesa më e madhe prej 2.300 hektarësh ka qenë shkurre, ndërkohë që pjesa tjetër ka



qenë pishë, ah dhe bimësi tjetër." - u shpreh zoti Peleshi. Zëvendësambasadori i Mbretërisë së Holandës në vendin tonë vlerësoi bashkëpunimin me autoritetet shqiptare dhe njoftoi se dy helikopterët holandezë "Chinook" dhe ekuipazhet e tyre do të vijojnë të

ndihmojnë në shuarjen e zjarreve deri në fund të muajit gusht. Helikopterët holandezë dhe ai çek, që prej datës 6 gusht i janë bashkuar përpjekjeve të Forcave të Armatosura dhe autoriteteve të tjera lokale për përballimin e situatës së krijuar nga zjarret.

Mbahet nën kontroll kurora pyjore e qytetit të Pukës

U angazhuan 50 efektivë të FA, 12 zjarrfikës, 8 punonjës të shërbimit pyjor, 20 vullnetarë

Zjarri në malin e Tërbunit në Pukë, vazhdoi të ishte problematike edhe në datën 16 gusht 2021. 50 efektivë të FA, 12 zjarrfikës, 8 punonjës të shërbimit pyjor, 20 vullnetarë punuan për mbajtjen në kontroll të situatës që të mos rrezikohej kurora e qytetit të Pukës.

Në fshatin Fletë, në Fushë - Arrëz situata u vu në kontroll ndërsa në fshatin Dardhë situata paraqitej më problematike për shkak të bimësisë së dendur. Ishte riaktivizuar vatra e zjarrit ndërmjet fshatrave Drihtë, Mazrek, Lundertune dhe Rragam në njësinë administrative Guri i Zi dhe Pobtribe duke e kthyer këtë zonë me 3 vatra zjarri. 25 trupa nga FA dhe 30 forca të tjera të pushtetit vendor kanë ndihmuar që situata në fshatin Patale në Lezhë të paraqitet e përmirësuar. Ndërsa në Mirditë, zjarri zhvillohej me intensitet të ulët. Në vatrën e zjarrit në fshatin Thirrë, vijoi puna në terren nga 40 trupa të FA dhe 14 nga strukturat vendore. Nga ajri u kryen ndërhyrje me helikopterin holandez. Vatra e zjarrit në majën e Rrunës, vazhdoi të ishte problematike. Në terren punuan 15 trupa nga FA dhe 20 forca nga strukturat vendore. Situata ishte e vështirë për shkak të terrenit të thyer. Zjarri në fshatin Kaçni, njësinë administrative Selishtë në Dibër, vazhdoi të ishte aktive në një sipërfaqe pyjore në terren të vështirë. Në terren punuan 15 trupa nga FA dhe 18 forca nga



strukturat vendore. Sipas vlerësimit të punës së bërë në terren u mendua që brenda ditës të arrihej të bëhej izolimi i vatrës. Vatër zjarri ishte aktivizuar edhe në Gurin e Nikës në Pogradec;

në vendin e quajtur kodrat e Divjakës pranë Parkut Kombëtar Divjakë; në fshatin Fushë - Arrëz në Luftinjë si dhe në fshatin Kamican në Elbasan, ku për të gjitha vatrave u punua për mbajtjen nën

kontroll të situatës.

Edhe më herët, gjatë datës 16 gusht 2021, vijoi pa u ndalur puna për shuarjen e zjarreve në vend, ku u punua për vatrën e shfaqur në anën tjetër të Malit të Tër-

bunit, e cila ishte zhvilluar nën ndikimin e erës. 42 efektivë të FA dhe rreth 30 forca të pushtetit vendor punuan ë për vatrën e zjarrit në fshatin Fletë në bashkinë e Fushë-Arrëzit dhe në fshatin Dardhë ku situata ishte delikate dhe u punua nga ajri me helikopterin tonë për ta izoluar. Në fshatin Thirrë situata u paraqit më e qetë dhe u punua për vënien nën kontroll të vatrave, ndërkohë vijoi sërish operacioni nga toka dhe ajri.

Në qarkun e Lezhës një ditë më parë u arrit 60% e izolimit të vatrave, ndërsa në bashkinë e Mirditës vatra e zjarrit ishte me intensitet të ulët. Në "Majën e Rrunës" situata e vatrave të zjarrit vazhdoi të ishte problematike. Terreni i vështirë nuk e ka ndaluar punën e efektivëve, të cilët vijuan edhe ditën tjetër të punojnë nga toka për vënien nën kontroll të disa prej vatrave. Në fshatin Kaçni në Dibër, gjatë natës zjarri u zhvillua në dy vatra dhe falë punës së efektivëve u bë e mundur që deri në fund të ditës të izolohej.

Edhe në 17 gusht 2021, situata e zjarreve në vend, vijoi të ishte aktive në disa vatra sidomos në pjesën veriore. Megjithatë situata e zjarreve në vend, u paraqit si më poshtë:

Qarku Shkodër: Mali i Tërëbunit, bashkia Pukë, zjarri vazhdoi të ishte aktiv në pjesën veriore dhe në pjesën lindore në Fushë - Kumulli. Në terren u angazhuan 40 forca të FA, 60 forca të bashkisë. Helikopteri holandez ka operuar nga ajri duke ulur intensitetin e flakëve. Zjarri është favorizuar nga era. Nuk u paraqit rrezik për banesat. Fshati Flet, njësi administrative Blerim, bashkia Fushë - Arrëz. Në terren janë angazhuar 40 forca ushtarake të FA dhe 40 forca të bashkisë. Problem vazhdo të ishte pjesa lindore e vatrës që po avanconte drejt kurorës së Fshatit Dardhë dhe Sakatit. Ishte e pamundur ndërhyrja nga toka. Si pasojë është përshkruar një sipërfaqe rreth 350 ha pyjore. Midis fshatrave Lodërtune, njësi administrative Postribë dhe Mazrek, njësi administrative Guri i Zi, Bashkia Shkodër, në terren janë angazhuar 60 forca të bashkisë që po punuan në të dy zonat për të mbajtur në kontroll situatën. Zjarri u favorizua nga era dhe forcat punuan me mjete rrethore për shkak të terrenit të vështirë. Fshati Drisht, njësi administrative Postribë, Bashkia Shkodër, zjarri ka përfshirë një sipërfaqe me shkurre dhe ferra. Mbi 30 forca punuan për shuarjen e zjarrit.

Qarku Lezhë: Thirrë, njësi administrative Fan, Bashkia Mirditë. Vatra e zjarrit pati një shtrirje shumë të madhe duke kaluar në fshatin Xhuxhë. Në terren janë angazhuar 1 mjet zjarrfikës me 5 efektivë, 30 forca ushtarake dhe forca nga autoritetet lokale. Helikopteri holandez ka operuar nga ajri duke bërë të mundur largimin e zjarrit nga banesat. Si pasojë e flakëve është djegur një sipërfaqe rreth 190 ha. Patalej, njësi administrative Kolsh, Bashkia Lezhë. Në terren janë angazhuar 1 mjet zjarrfikës me 3 efektivë, 25 forca ushtarake, rreth 20 forca nga autoritetet lokale si dhe vullnetarë. Ka vijuar ndërhyrja nga ajri me helikopterin çek dhe zjarri është drejt shuarjes përfundimtare. Si pasojë është djegur një sipërfaqe rreth 33.5 ha me shkurre dhe pemë. Në fshatin Katund i Vjetër, Malung, njësi administrative Rubik, Bashkia Mirditë, zjarri ka përfshirë një sipërfaqe pylli dhe shkurre të dendura. U punua për shuarjen e zjarrit, ndërkohë që zona ishte e banuar dhe zjarri mund të ishte rrezik për banorët. Pranë banesave u dislokua një mjet zjarrfikës.

Qarku Kukës: Maja e Rrunës, ka zbritur zjarri me poshtë në vendin e quajtur Laku i Mollave dhe Laku i Thive, njësi administrative Malzi, Bashkia Kukës. Zjarr në sipërfaqe pishë dhe ah. Zjarri u favorizua nga era dhe helikopteri holandez ka punuar për shuarjen e tij, ndërkohë që në terren janë angazhuar 35 trupa nga FA dhe autoritetet lokale.



Zjarret, angazhohen në terren forca të FA dhe forca të bashkive

Helikopteri holandez operoi nga ajri duke ulur intensitetin e flakëve

Në terren janë angazhuar 40 forca ushtarake të FA dhe 40 forca të bashkisë. Problem vazhdo të ishte pjesa lindore e vatrës që po avanconte drejt kurorës së Fshatit Dardhë dhe Sakatit. Ishte e pamundur ndërhyrja nga toka. Si pasojë është përshkruar një sipërfaqe rreth 350 ha pyjore.

Rreth orës 15:05, në fshatin Dragobi, njësi administrative Margegaj, Bashkia Tropojë, zjarri përfshiu një zonë pyjore. U punua për izolimin dhe shuarjen e kësaj vatre. Rreth orës 15:16, në afërsi të fshatit Golaj, njësi administrative Golaj, Bashkia Has, ra zjarr në një sipërfaqe pyjore. U punua për izolimin dhe shuarjen e kësaj vatre.

Qarku Dibër: Kaçni, njësi administrative Selishtë, Bashkia Dibër u punua për izolimin dhe shuarjen e kësaj vatre. Zjarri vazhdoi me intensitet mesatar. Nuk pati rrezik për banesat.

Qarku Vlorë: Më datë 17.08.2021, ora 11:15, në fshatin Kallarar, njësi administrative Hor Vranisht, Bashkia Himarë, ka rënë zjarr në një sipërfaqe

me shkurre dhe ferra. Shërbimi vendor i MZSH të bashkisë Himarë ka dërguar në vendngjarje 1 mjet zjarrfikës me 3 efektivë dhe shumë shpejt zjarri ishte drejt shuarjes.

Qarku Korçë: Më datë 17.08.2021, ora 14:45, ra zjarri në vreshtë në Leskovik, në pronësi të shtetasit A. G. U punua për izolimin dhe shuarjen e kësaj vatre.

Qarku Durrës: Më datë 17.08.2021, ora 14:45, në fshatin Barkanesh, Bashkia Krujë, ka rënë zjarr në një sipërfaqe me shkurre dhe ferra. U punohet për izolimin dhe shuarjen e kësaj vatre.

Më datë 17.08.2021, ora 17:10, në fshatin Maskuri, njësi administrative Rrashbull, Bashkia Durrës, ka rënë zjarr në sipërfaqe me shkurre, ferra dhe ullinj. 3 mjete dhe 9 efektivë, të cilët punuan për të vënë zjarrin nën kontroll.

Qarku Elbasan: Më datë 17.08.2021, ora 17:00, në njësinë ad-

ministrative Rrajcë, bashkia Prrenjas, ka rënë zjarr në një sipërfaqe me shkurre, ferra dhe pyje. Zjarri ka marrë përmasa ndërkohë këto pyje janë pjesë e UNESCO, si dhe kanë një rëndësi të veçantë. Mjetet dhe forcat, të cilat u nisën për këtë operacion ekishin të pamundur shuarjen e tij, pasi është terren i vështirë, por ato punuan në zonën ku mund të prekeshin banesat. Gjithashtu më datë 17.08.2021, ora 17:45, në fshatin Fatishe, njësi administrative Përparim, Bashkia Peqin, ka rënë zjarr në një sipërfaqe me shkurre dhe ferra dhe u punua për izolimin dhe shuarjen e kësaj vatre.

Qarku Gjirokastrë: Më datë 17.08.2021, ora 19:00, në fshatin Lab Maralloz, njësi administrative Lopës, Bashkia Tepelenë, ka rënë zjarr në një sipërfaqe me shkurre dhe ferra. Forcat punuan për izolimin dhe shuarjen e kësaj vatre.

Kapiten Budani fiton bursën për masterin shkencor për Sigurinë Kombëtare "Chevening"

Chevening, është një bursë prestigjioze ndërkombëtare që jepet nga Ministria e Jashtme Britanike për "Liderët Botërorë të së Ardhmes".

Kapiten Hekuran Budani është fituesi i kësaj burse në master shkencor për Siguri Ndërkombëtare në Universitetin e Londrës për vitin akademik 2021-2022. Kapiten Budani aktualisht shërben me shumë përkushtim në Departamentin e Formimit Ushtarak si përgjegjës grupi dhe gjithashtu si pedagog pranë Akademisë së Forcave të Armatosura. Arsimimi nëpërmjet bursës Chevening, në fushën e Sigurisë Ndërkombëtare do të jetë një vlerë e shtuar për Forcat e Armatosura, por edhe një kontribut i çmuar në ndërtimin e programeve të tjera master në Akademinë e Forcave të Armatosura.



Situata e zjarreve në vend

Përhapja u favorizua nga era e fortë, rreth 100 forca të FA në terren

Në të gjithë vendin u punua për shuarjen e 10 vatrave të zjarrit, në 15 gusht 2021, një pjesë e të cilave ishin të reja dhe një pjesë të favorizuara në përhapje nga era e fortë.

Një vatër e re zjarri u shfaq, nën ndikimin e erës në Malin e Tërbunit, bashkia Pukë, ku u punua gjatë ditës nga forcat e FA për krehjen e zonës. Përhapja e zjarrit rrezikoi kurorën e qytetit të Pukës, por nuk pati rrezik për banesat. Të nesërmen vijoi sërish operacioni për vënien nën kontroll të situatës.

Ndërhyrja nga ajri në vatrën e zjarrit në fshatin Flet, njësi administrative Blerimaj, bashkia Fushë - Arrëz u ndërpre si pasojë e telave elektrikë që rrezikonin punën e helikopterit holandez. Por në terren punuan rreth 100 forca të FA dhe pushtetit vendor. Nga ana e fshatit Kryezi u vu nën kontroll zjarri gjithashtu. Nga fshati Dardhë situata ishte më e rrezikshme dhe u punua nga forcat për ta izoluar. Nuk pati rrezik për banesat. Një zjarr me përmasa të mëdha u raportua në një sipërfaqe pyjore pishë dhe shkurre, midis fshatrave Lodertune, njësi administrative Postribë dhe Mazrek, njësi administrative Guri i Zi, bashkia Shkodër. Mazreka është një zonë me vlera historike dhe turistike, ku ndodhen rrënojat e Kishës së Shatit, monument kulture i kategorisë së parë. Në mbështetje nga ajri ishte edhe helikopteri holandez.

Vijoi puna për shuarjen e zjarrit në fshatin Patalej, njësi administrative Kolsh, bashkia Lezhë. Sipërfaqja e përshkruar deri në datën 15 gusht ishte 30 ha, ndërsa ishte djegur 15 ha shkurre dhe pemë. Vatra ka qenë aktive brenda perimetrit të përshkruar nga zjarri dhe gjatë kohës është përhapur në Veri - Lindje të fshatit Lalm të njësisë administrative Kolsh, Lezhë dhe të kufirit administrativ me njësinë administrative Rubik, bashkinë Mirditë, përkatësisht në afërsi të fshatit Katund i Vjetër, ku në gatishmëri ishte vendosur një mjet zjarrfikës i FA për ruajtjen e 4 banesave aty pranë. Vijoi akoma mbështetja nga ajri dhe pas punës së ditës u arrit 60% e izolimit të vatrave. Operacioni vijoi sërish operacioni për shuarjen përfundimtare.

Ishte përmirësuar disi situata në fsha-



tin Thirrë, njësi administrative Fan, bashkia Mirditë, ku situata ishte përkeqësuar si pasojë e erës. Ndërkohë flakët përshkuan rreth 220 ha ah, pishë, barishte e dushk dhe djegur 140 ha kullota. Veç forcave të FA, policisë, zjarrfikëses gjatë ditës punoi edhe helikopteri holandez, i cili ka ndihmuar në uljen e ritmit të përhapjes së zjarrit krahasuar me ditën e djeshme. Operacioni vijoi sërish të nesërmen. Nuk pati rrezik për banesat. Nga ana tjetër vazhdoi të ishte problematike vatra e zjarrit në Majën e Rrunës, Laku i Mollave dhe Laku i Thive, njësi administrative Malzi, bashkia Kukës, pavarësisht punës së bërë

nga forcat e angazhuara të bashkisë dhe FA për izolimin dhe mbajtjen e saj nën kontroll. Vazhdonin të digjeshin trungje brenda vatrës. Terrenishte i vështirë dhe në disa drejtime e pamundur ndërhyrja nga toka. Vijoi të jetë aktiv zjarri në fshatin Kaçni, njësi administrative Selishte bashkia Dibër. Pavarësisht punës së bërë nuk u arrit izolimi i flakëve që po përhapeshin në zonë pyjore. Të nesërmen në mbështetje të forcave të pushtetit vendor shkuan edhe rreth 30 efektive të FA.

Një vatër zjarri në një sipërfaqe me shkurre dhe ferra u raportua në fshatin Vanë, njësi administrative Delvinë, bash-

kia Delvinë. Forcat e zjarrfikëse ishin në terren dhe nup pati rrezik. Po ashtu një vatër e re ishte në fshatin Kamican, njësi administrative Zavalinë, bashkia Elbasan në pyll me pisha. Forcat e MZSH të bashkisë ishin në terren dhe punuan për izolimin e vatrave.

Edhe më herët në datën 15 gusht 2021, disa vatra zjarri, kryesisht në veri të vendit u raportuan ende aktive pavarësisht punës së pandërprerë të forcave operacionale në terren, asistencës së ekspertëve nga Byroja për Ndihmë Humanitare e USAID dhe mbështetjes me helikopterët shqiptarë, holandezë e çekë nga ajri.

Situata u paraqit e normalizuar në vatrën e zjarrit në Malin e Tërbunit në Pukë, ku ende punohej me mbi 50 forca të FA për të kryer krehjen e zonës. Në vatrën e zjarrit në fshatin Flet, njësi administrative Blerimaj, bashkia F. Arrëz ndërkohë u punua nga rreth 100 forca të FA dhe pushtetit vendor. U ndërpre puna nga ajri e helikopterit holandez, për shkak të telave elektrikë që ishin shumë lart dhe rrezikonin punën e tij. Zjarri nga ana e fshatit Kryezi është vënë nën kontroll, ndërsa nga fshati Dardhë situata ishte më e rrezikshme dhe u punua nga forcat për ta izoluar. Era ka ndikuar në përhapjen e flakëve në fshatin Patalej, njësi administrative Kolsh, bashkia Lezhë. Sipërfaqja e përshkruar ndërkohë ishte 30 Ha, ndërsa ishte djegur rreth 15 Ha shkurre dhe pemë. Forcat e Armatosura, të policisë, ato zjarrfikëse, të pushtetit vendor dhe forca vullnetare punojnë për shuarjen e flakëve. Zjarri për momentin nuk rrezikonte banesat, por vijonte përhapja e

tij në Veri-Lindje të fshatit Lalm të Njesisë Administrative Kolsh, Lezhë dhe të kufirit administrativ me Njesinë Administrative Rubik, bashkinë Mirditë, përkatësisht në afërsi të fshatit Katund i Vjetër. Ka filluar më pas ndërhyrja nga ajri e Helikopterit Cek për izolimin e zjarrit e më pas do të ndërhyhej me forca ushtarake e bashkiake për të bërë krehjen e plotë të perimetrit të vatrës në mënyrë që të bëhej izolimi i plotë. Përkeqësimi pati situata në fshatin Thirrë, njësi administrative Fan, bashkia Mirditë, si pasojë e erës. Ishin përshkruar ndërkohë rreth 220 ha ahe, pishë, barishte e dushk dhe ishin djegur 140 ha kullota. Vatra e zjarrit ishte e pamundur të kontrollohej vetëm nga toka për shkak të përhapjes dhe në mbështetje të forcave të FA dhe pushtetit vendor shkoi edhe helikopteri holandez.

Vatra e zjarrit në "Majën e Rrunës", Laku i Mollave dhe Laku i Thive, njësi administrative Malzi, bashkia Kukës vazhdoi të ishte problematike me gjithë punën e bërë nga forcat e angazhuara nga bashkia Kukës si dhe angazhimi nga ajri me helikopter. Vijoi puna edhe nga forcat zjarrfikëse, të shërbimit pyjor dhe forcat vullnetare. Por terreni për ndërhyrjen e forcave nga toka është i vështirë, gjë që ndërlikoi izolimin e zonës. Nuk u paraqit rrezik për banesat dhe vijoi puna për mbajtjen nën kontroll të vatrës në Qafë Murrë, njësi administrative Selishte, B. Dibër. Zjarri ka kaluar në një terren shkëmbor dhe me bimësi të pakët. Zjarri në fshatin Kaçni, njësi administrative Selishtë bashkia Dibër u zhvillua me ritëm të shtuar dhe doli jashtë kontrollit duke u afuar në masivin me pisha në territorin e bashkisë Klos. Zjarri u përhap

Gjatë natës situata u monitorua nga forcat zjarrfikëse për të mos lejuar kalimin në fshatra

U pozicionuan në terren edhe mbi 150 forca të FA

Disa vatra zjarri janë ende aktive në vend, u njoftua më 14 gusht. "Situata është problematike në fshatin Flet në Fushë-Arrëz, ku flakët rrezikojnë t'u afrohen banesave. Për shuarjen e tyre ka filluar puna nga toka e ajri. Me prioritetet po punohet edhe në fshatin Thirrë në Mirditë, ku vatra ka zgjeruar perimetritin e forcat në terren kanë vështirësi për shkak të tymit të krijuar.

Puna ka vijuar edhe në "Majën e Rrunës", Laku i Mollave e Laku i Thive në Kukës, ku gjendja është në përmirësim dhe nuk ka rrezik për banesat. E njëjta situatë është edhe në fshatin Patej në Lezhë. Ndërsa prej mëngjesit ka nisur edhe ndërhyrja nga ajri në malin e Tërbunit në Pukë, ku janë pozicionuar edhe mbi 150 forca të FA në terren." tha ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi.

Në 14 gusht 2021, zjarri në malin e Tërbunit, bashkia Pukë u izolua në masën 70%, pas punës së forcave në terren dhe ndërhyrjes nga ajri të helikopterit holandez. Situata është përmirësuar ndjeshëm, por ka mbetur vetëm një drejtim i vatrës së zjarrit në vendin e quajtur qafa e Kumbullës ku u punua nga të gjitha forcat në këtë zonë. Kurse vatra e zjarrit në fshatin Flet, njësi administrative Blerimaj, bashkia Fushë - Arrëz vijoi të jetë aktive. Pavarësisht punës së bërë nga të gjitha forcat nga toka e ajri, zjarri po përparonte drejt majës së Shtrazicës me sipërfaqe pishë, në kufi me fshatin Dardhë, ndërsa në drejtim të

fshatit Kryezi është mbajtur nën kontroll. Era favorizoi përhapjen me shpejtësi të zjarrit, kur ishin përshkruar 30 ha me shkurre dhe pemë të ndryshme. Gjatë natës situata u monitorua nga forcat zjarrfikëse për të mos lejuar kalimin në fshatra. E strukturatishin në ndjekje të situatës. Situata është përkeqësuar ndërkohë në fshatin Thirrë, njësi administrative Fan, bashkia Mirditë, si pasojë e erës. Janë përshkruar rreth 200 ha. Pavarësisht punës së bërë nga 80 forca, ndër të 60 efektive të FA, nuk është bërë i mundur izolimi i vatrës. Si pasojë e terrenit të vështirë dhe erës puna



e forcave ka qenë e rrezikshme, por nuk paraqitet rrezik për banesat. Të nesërmen vijoi ndërhyrja nga ajri.

Vijoi të ishte aktive vatra në majën e Rrunës, Laku i Mollave dhe Laku i Thive, njësi administrative Malzi, bashkia Kukës.

Situata është përmirësuar disi, por pati ende vatra të vogla në të gjithë malin. Nuk ka rrezik për banesat. Në këtë zonë afër fshatit Shemëri operonte helikopteri çek. Në zonë forcat nga toka e kanë të pamundur ndërhyrjen.

Nuk ka probleme për banesat edhe në vatrën e zjarrit në qafë Murrë, njësi administrative Selishte, bashkia Dibër, ku flakët kanë kaluar në një terren shkëmbor dhe me bimësi të pakët.

Zjarri në fshatin Kaçni, njësi administrative Selishtë bashkia Dibër, po zhvillohet me ritëm të shtuar dhe ka dalë jashtë kontrollit duke u afuar në masivin me pisha në territorin e bashkisë Klos. Forcat operacionale janë në ndjekje të situatës. Zjarri i rënë në një sipërfaqe pylli me pisha, në fshatin Gllavë, njësi administrative Buz, bashkia Memaliaj nuk paraqet rrezik për banesat. Në terren janë forca zjarrfikëse dhe banorë të zonës.

Edhe më herët në 14 gusht 2021, ka vijuar puna e forcave operacionale për shuarjen e zjarrit në fshatin Patalej, njësi

administrative Kolsh, bashkia Lezhë. Situata nuk paraqet rrezik për banesat. Zjarri në fshatin Thirrë, njësi administrative Fan, bashkia Mirditë, ka zgjeruar pak perimetritin. Forcat operacionale po përballen me vështirësi për shkak të tymit të krijuar. Po punohet për izolimin e vatrës së zjarrit. Në përmirësim ishte situata në majën e Rrunës, Laku i Mollave dhe Laku i Thive, njësi administrative Malzi, bashkia Kukës, ku ka vijuar puna për shuarjen e vatrave të zjarrit. Në zonë po operonte edhe një helikopter dhe nuk u paraqit rrezik për banesat, apo forcat në terren. Filloi prej mëngjesit ndërhyrja nga ajri për shuarjen e flakëve në malin e Tërbunit, bashkia Pukë, ku gjithashtu punuan mbi 150 efektive të FA. Jo e mirë u paraqit situata në vatrën e zjarrit në fshatin Flet, njësi administrative Blerimaj, bashkia Fushë - Arrëz, pasi zjarri po përhapej me shpejtësi në drejtim të banesave. Filloi dhe ndërhyrja nga ajri me helikopter. Vatra zjarri pati gjithashtu midis fshatrave Kacni dhe qafë Murrë, njësi administrative Selishtë, bashkia Dibër. Zjarri pati përmirësim në qafë Murre, pasi kaloi në një terren shkëmbor dhe me bimësi të pakët. Zjarri në fshatin Kacni, njësi administrative Selishtë bashkia Dibër, u zhvillua me ritëm të shtuar në terren të vështirë, pa rrezik për banesat. Në këtë zonë, zjarri ishte më i shtuar për shkak të bimësisë dhe drurëve të dendur. U punua nga forcat në terren për ta mbajtur larg zonës së banuar (pjesë e bashkisë Klos).

Vijojnë intensivisht operacionet nga ajri për shuarjen e zjarreve në veri të vendit

Helikopteri Cougar hodhi rreth njëqind mijë litra ujë në zonën e operimit

Helikopteri Cougar me ekuipazhet e pilotëve dhe teknikëve në bord ka kryer misionet e ndërhyrjes nga ajri për shuarjen e zjarreve në veri të vendit. Operacionet nga ajri gjatë paradites janë kryer në fshatin Fletë, Fushë-Arrëz duke bërë të mundur eliminimin e vatrave të zjarrit në pyjet e këtij rajoni.

Pasditën e 16 gusht 2021, helikopteri Cougar ka fluturuar drejt Shkodrës në fshatin Postribë në rajonin e Gurit të Zi, operacion ky për shuarjen e zjarreve, i cili ka zgjatur deri në orët e vona të kësaj fillim jave. Në këto ndërhyrje nga ajri nëpërmjet kovës speciale “bambi bucket”, helikopteri Cougar ka hedhur rreth njëqind mijë litra ujë në këto zona operimi.

Edhe në datën e 16 gusht 2021, helikopteri holandez “Chinook” ka operuar për shuarjen e zjarreve në Thirrë, Kalimash dhe malin e Tërbunit në zonën e Pukës ndërsa helikopteri çek ka operuar në Patalej, Lezhë. “Angazhimi maratonë, nga toka e ajri, i strukturave të mbrojtjes civile, bëri që situata në fshatin Flet në Fushë Arrëz, në Mirditë dhe në Patale të Lezhës të vihej në kontroll. Vazhdojnë me inensitet operacionet për përmirësimin e situatës së zjarreve në fshatin Thirrë, në “Majën e Runës”



si dhe në Malin e Tërbunit në Pukë ku po bëhen përpjekjet maksimale për të mbajtur të mbrojtur kurorën e qytetit të Pukës.”, shkroi ministri i Mbrojtjes

Niko Peleshi në rrjetin social teksa publikoi videon me fluturimin e helikopterit Cougar gjatë operacionit të shuarjes të zjarreve.



Helikopteri Cougar përkrah helikopterëve Chinook Hollandez dhe AB 412 Çek

Rikonicion, transport i trupave në zonat e vështira dhe shuarje zjarresh nga ajri

Mbas operacioneve për shuarjen e zjarreve në Karaburun dhe Dukat, helikopteri Cougar përkrah me helikopterët Chinook Hollandez dhe AB 412 Çek në 14 gusht 2021, vijuan operimin në zonën veriore të vendit në Kukës dhe Pukë duke vënë nën kontroll zjarret e mëdha me ujin e mbushur në liqenin afër nëpërmjet kovës “Bambi Bucket”, si dhe duke alternuar operimet edhe me helikopterin çek i cili ka kryer misione gjithashtu në zonën e Kukësit.

Helikopterët e angazhuar kanë punuar me intensitet në zonat e mbuluara nga tymi e më të rrezikuara nga flakët në Malin e Tërbunit, Pukë, Kukës dhe rrethinat përreth, madje duke kryer kështu edhe një spektër të plotë të detyrave si rikonicion, transport të trupave në zonat e vështira për tu arritur nga mjetet tokësore dhe shuarje zjarresh nga ajri.

Helikopteri Cougar dhe ekuipazhet janë duke kryer misione ditore mbi 6 orë fluturimi, ritual intensiv



angazhimi duke hedhur mbi 40 kova me ujë me 2500 litra secila kovë, ndërhyrje nga ajri të cilat koordinohen në përputhje me prioritetet për shpëtimin e shtëpive që rrezikohen nga zjarri.

Ndërhyrja e helikopterëve Cougar të FARSH, Chinook Hollandez dhe AB 412 Çek janë efektive dhe neutralizuese duke realizuar shuarjen e zjarreve në zonat e operimit.

MISIONET



Misionet për shuarjen e vatrave të zjarrit në veri të vendit në zonën Fushë – Arrëz

Helikopteri Cougar i Forcës Ajrore është angazhuar këtë fundjavë dhe vazhdon me intensitet prej disa orësh misionet për shuarjen e disa vatrave të rrezikshme të zjarrit në veri të vendit në zonën Fushë - Arrëz. Megjithëse në një terren të thyer e të vështirë, ekuipazhet e pilotëve dhe teknikëve të Forcës Ajrore po realizojnë me përkushtim ndërhyrjen nga ajri për eliminimin e zjarreve.

Në operacionin për shuarjen e zjarreve vazhdojnë të marrin pjesë gjithashtu helikopteri holandez “Chinook” në malin e Tërbunit në zonën e Pukës si dhe helikopteri çek në Shën Mëri në zonën e Kukësit.

Në këto operacione të ndërhyrjes nga ajri, janë kryer dhjetëra fluturime dhe janë hedhur qindra mijëra litra ujë duke ndihmuar në shuarjen dhe vënien në kontroll të vatrave të zjarrit në këto zona.

EFEKTIVAT E FORCËS TOKËSORE NË SHUARJE ZJARRI

Angazhim deri në fikjen e plotë të vatrave të zjarrit në të gjithë vendin

Efektivat e Forcës Tokësore vijojnë të jenë të angazhuara prej më shumë se një muaji në operacione për shuarjen e zjarreve në vend. Në 17 gusht 2021, u raportuan se janë mbi 100 efektivë të reparteve të ndryshme të Forcës Tokësore, që janë rreshtuar përkrah forcave zjarrfikëse për shuarjen e vatrave të zjarrit në Fushë - Arrëz, Rubik, Thirrë të Mirditës dhe mali i Tërbunit, Pukë.

Angazhimi i efektivave të Forcës Tokësore do të vazhdojë deri në fikjen e plotë të vatrave të zjarrit në të gjithë vendin tonë.



Specialistët EOD eliminojnë rrezikun e municioneve të gjetura në Pukë

Specialistët xheniere të EOD, mbrëmjen e datës së 17 gushtit 2021 pas sinjalizimit për gjetje municionesh të paplasura në vendin e quajtur "Rezervuari i Kukajve" në Pukë kanë shkuar menjëherë në vendngjarje dhe pas kryerjes së vlerësimit të rastit, ndoqën procedurat për mënjanimin e rrezikut të municioneve të evidentuara në mes të cilave kishte dhe predha artilerie të kalibrë 71mm, 100mm, 120mm, 152mm dhe 150 mm, predhë mortaje 82 mm si dhe 7 granata dore mësymëse duke përfunduar detyrën me sukses.

Komanda Mbështetëse ka dhënë kontribut të konsiderueshëm në vite duke shpalosur një kapacitet të vyer jo vetëm në shërbim të misionit të Forcave të Armatosura për pastrimin e asgjësimit të municioneve të paplasura në poligonet ushtarake, por edhe në shërbim të komunitetit për eliminimin e rreziqeve të municioneve të gjetura si në zonat rurale ashtu dhe ato urbane.

Municionet e paplasura u transportuan për në Batalionin e Xhenios ku do të magazinohen deri në asgjësimin përfundimtar të tyre.



Komanda Mbështetëse vijon operacionin e shuarjes së vatrave të zjarrit në vend

Që prej fillimit të muajit gusht, efektivët e Komandës Mbështetëse janë angazhuar në fikjen e zjarrit në zona të ndryshme të vëndit, aktualisht në Burrel e Kukës duke sfiduar terrenin dhe temperaturat ekstreme.

NSPA po luan një rol udhëheqës si pjesë e përgjigjes së NATO-s ndaj COVID-19. Agjencia siguron mbështetje logjistike dhe organizon transportin e furnizimeve dhe pajisjeve kryesore për aleatët, partnerët dhe organizatat e tjera ndërkombëtare. Për shembull, NSPA i ka siguruar Luksemburgut spitale në terren për të rritur kapacitetin e tij spitalor dhe ka dërguar ventilatorë të Njësisë së Kujdesit Intensiv në Itali, pajisje mbrojtëse personale në Spanjë



dhe furnizime mjekësore në Norvegji. Aftësitë e NSPA grupohen në tre fusha: mbështetje për operacionet dhe stërvitjet; menaxhimi i ciklit të jetës; dhe shërbimet.

Mbështetje për operacionet dhe ushtrimet

NSPA mbështet operacionet dhe ushtrimet e NATO-s përmes shërbimeve mbështetëse të jetës reale, të tilla si akomodimi, ushqimi dhe shërbimet mjekësore; infrastruktura; mbështetjen e aeroportit dhe shërbime të tjera logjistike për trupat. Agjencia gjithashtu menaxhon kontrata për karburant, furnizime me naftë dhe shërbime portuale për transportin detar. Përmes Qendrës së saj Operative Jugore (SOC), e vendosur në Taranto, Itali, NSPA prokuron, menaxhon, operon dhe mirëmban infrastrukturën e kampit të vendosshëm dhe shërbimet e lidhura me to të kontraktuara për NATO-n dhe aleatët e saj. Agjencia ka qenë e angazhuar ngushtë në planifikimin dhe mbështetjen e kombeve në aktivitetet e parandalimit dhe mbrojtjes. Për më tepër, NSPA është përgjegjëse për zbatimin e projekteve të Fondit të Mirëbesimit të NATO-s, duke mbështetur projektet e lidhura me sigurinë dhe mbrojtjen dhe ngritjen e aftësive në vendet partnere.

Menaxhimi i ciklit të jetës së pajisjeve

NSPA mbikëqyr të gjitha fazat në ciklin jetësor të pajisjeve dhe

sistemeve të armëve (nga blerja deri në daljen në pension të sistemit të armëve, me një fokus të veçantë në mbështetjen gjatë shërbimit). Agjencia punon ngushtë me klientët e saj duke përshtatur mbështetjen e saj në çdo fazë për të përmbushur kërkesat e klientëve.

NSPA aktualisht menaxhon 32 partneritete mbështetëse shumëkombëshe që mbulojnë mbi 90 sisteme kryesore të armëve (helikopterë, radarë, raketa, automjete të blinduara, sisteme të mbikëqyrjes ajrore, etj.). Duke përfshirë projekte me shikueshmëri të lartë, siç janë: Mbikëqyrja dhe Kontrolli i Ardhsëm i Aleancës (AFSC); Flota e Transportit të Tankerave Shumë-Role (MRTT) (MMF); Mbikëqyrja tokësore e Aleancës (AGS); Municionet e drejtuara me saktësi dhe Municionet vendimtare të betejës tokësore; Automjete dhe Pajisje Luftarake Tokësore; Mbrojtja Ajrore me Bazë Tokësore (GBAD); Zgjidhja Strategjike Ajrore Ndërkombëtare (SALIS)

Shërbimet

NSPA mban një portofol të gjerë të produkteve dhe shërbimeve në fushën e mbështetjes logjistike, siç është Bursa e Logjistikës e NATO-s (NLSE), e cila lejon klientët të organizojnë shkëmbimin e pjesëve të tepërta të këmbimit dhe të menaxhojnë aksionet e mbajtura zakonisht, ose Prokurimet e Përgjithshme të Ndarura Shërbimet (GPSS), e cila

siguron kontrata strategjike për burime dhe qasje në Qendrën eShopping të NATO-s.

Nga Versaja, Francë, NSPA menaxhon Sistemin e Tubacioneve të Evropës Qendrore (CEPS). CEPS është sistemi më i madh i tubacioneve të naftës të NATO-s. Krijuar në fillim të viteve 1950, CEPS u krijua për transportin, ruajtjen dhe shpërndarjen e llojeve të ndryshme të karburantit për të furnizuar forcat ushtarake të Aleancës në Evropën Qendrore. Që nga viti 1960, CEPS gjithashtu dërgon karburant në aeroportet kryesore civile si Brukseli, Frankfurti, Luksemburgu, Schiphol dhe Cyrihu. Përdorimi jo-ushtarak i CEPS lejohet nga Këshilli i Atlantikut të Veriut me kusht që përparësi t'i jepet aftësisë ushtarake.

Në Hungari, Programi i Menaxhimit të Transportit Ajror të NATO-s (NAMP) mbështet aftësinë strategjike të ngritjes ajrore (SAC) dhe avionët C-17 të Heavy Airlift Wing (HAW). NAMP fiton, menaxhon dhe mbështet asetet e transportit ajror të kërkuara për operacionet kombëtare, përfshirë ato në mbështetje të NATO-s, Bashkimit Evropian, Kombeve të Bashkuara dhe angazhimeve shumëkombëshe.

Struktura

NSPA ka selinë në Dukatin e Madh të Luksemburgut, me qendrat kryesore operative në Francë, Hungari dhe Itali dhe stacione në Kosovë

dhe Afganistan. Agjencia punëson rreth 1,550 punonjës dhe mbikëqyr mbi 2,500 kontraktorë në misionet e NATO-s në të gjithë botën.

NSPA i raporton Këshillit të Atlantikut të Veriut. E drejtuar nga një menaxher i përgjithshëm, Agjencia është organi ekzekutiv i Organizatës për Mbështetjen dhe Prokurimin e NATO-s (NSPO), në të cilën të gjithë aleatët e NATO-s janë anëtarë. Ato kombe përfaqësohen në Bordin Mbikëqyrës të Agjencisë NSPO (ASB), i cili drejton dhe kontrollon aktivitetet e NSPA.

Evolucion i Agjencisë

Në vitin 1958, Këshilli i Atlantikut të Veriut miratoi krijimin e Agjencisë së Shërbimeve të Furnizimit të Mirëmbajtjes të NATO-s (NMSSA), në Châteauroux, Francë për të përmbushur kërkesat logjistike të kombeve aleate.


Pesë vjet më vonë, NMSSA ndryshoi emrin e saj duke u bërë Agjencia e Mirëmbajtjes dhe Furnizimit e NATO-s (NAMSA). Në vitin 1968, NAMSA u zhvendos nga baza e saj origjinale në Châteauroux në Luksemburg, ku selia e Agjencisë është ende.

Gjatë dekadave, Agjencia është përshtatur me ndryshimet në teknologji, kushtet politike dhe strategjike, si dhe përparimet në zhvillim të NATO-s në logjistikën e mbrojtjes kolektive.

Në Samitin e Lisbonës 2010, udhëheqësit aleatë ranë dakord të reformojnë 14 Agjencitë ekzistuese të NATO-s, të vendosura në shtatë vende anëtare. Në veçanti, ata ranë dakord të drejtojnë agjencitë në tre tema kryesore programore: prokurimi, mbështetja dhe komunikimet dhe informacioni. Reforma synonte të rrisë efikasitetin dhe efektivitetin në ofrimin e aftësive dhe shërbimeve, të arrijë sinergji më të madhe midis funksioneve të ngjashme dhe të rrisë transparencën dhe llogaridhënien.

Si pjesë e procesit të reformës, NSPA u krijua më 1 korrik 2012 duke bashkuar tre ish agjenci mbështetëse gjatë shërbimit: Agjencia e Mirëmbajtjes dhe Furnizimit të NATO-s (NAMSA), Agjencia e Menaxhimit të Transportit Ajror të NATO-s (NAMA) dhe Agjencia e Menaxhimit të Tubacioneve të Evropës Qendrore (CEPMA)

Në prill 2015, Agjencia për Mbështetjen e NATO-s u bë Agjencia e Mbështetjes dhe Prokurimit e NATO-s, duke shënuar zgjerimin e aftësive të saj për të përfshirë të gjitha aspektet e prokurimit të sistemeve nga blerja fillestare gjatë gjithë qëndrueshmërisë.



Ministri Mehaj shprehu falënderimin dhe mirënjohjen e thellë për rolin dhe kontributin e madh të Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Turqisë, në ndërtimin dhe zhvillimin e gjithmbarshëm të Ministrisë sonë të Mbrojtjes dhe Forcave të Sigurisë së Kosovës.



Partneritet ndërmjet dy ministrive dhe forcave

Ministri Mehaj u prit në takim nga ministri i Mbrojtjes Kombëtare të Turqisë, Hulusi Akar

Në kuadër të vizitës zyrtare në Republikën e Turqisë, respektivisht, pjesëmarrjes në Panairin "IDEF'21", ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj u prit nga homologu i tij ministri i Mbrojtjes Kombëtare të Turqisë, Hulusi Akar në 18 gusht 2021. Gjatë këtij takimi, ministri turk theksoi partneritetin e fuqishëm ndërmjet dy ministrive dhe forcave, në funksion të paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal dhe më gjerë. Nga ana e tij, ministri Mehaj shprehu falënderimin dhe mirënjohjen e thellë për rolin dhe kontributin e madh të Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Turqisë, në ndërtimin dhe zhvillimin e gjithmbarshëm të Ministrisë sonë të Mbrojtjes dhe Forcave të Sigurisë së Kosovës. Me tej, gjatë këtij takimi u diskutua për bashkëpunimin bilateral në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, si dhe bashkëpunimin në fushën e industrisë së mbrojtjes, me fokus në programet konkrete ndërshtetërore.



STAMBOLL IDEF-21

Ministri Mehaj mori pjesë në Panairin të Industrisë së Mbrojtjes

Me ftesë zyrtare të ministrit turk të Mbrojtjes, Hulusi Akar, ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, filloi vizitën katër ditore në Republikën e Turqisë, me fokus pjesëmarrjen në Panairin e 15-të Ndërkombëtar të Industrisë së Mbrojtjes, IDEF-21, në 17 gusht. Gjatë katër ditëve të këtij panairi, të mbajtur në Stamboll, ndër më të njohurit në botë, ministri Mehaj, i shoqëruar nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, përveç takimit me ministrin Akar, do të takohet edhe me homologë të tjerë nga shtete të ndryshme partnere dhe shtete me të cilat Ministria e Mbrojtjes është në proces të krijimit të bashkëpunimit bilateral. Gjithashtu, gjatë katër ditëve të panairit, ministri Mehaj, do të takohet me liderë përfaqësues të kompanive të ndryshme të industrisë së mbrojtjes pjesëmarrëse nga 83 shtete të botës. Me këtë rast, ministri Mehaj theksoi se "kjo është një mundësi shumë e mirë të



njihemi me produktet që ndërlihen me objektivat tonë në funksion të ngritjes së aftësive dhe kapaciteteve operationale të FSK-se në procesin e tranzicionit". Panairi Ndërkombëtar i Industrisë së Mbrojtjes (IDEF) i cili organizohet çdo dy vjet nga Fondacioni i Forcave të Armatosura të Turqisë

është panair ku ekspozohen produktet të teknologjisë më bashkëkohore ushtarake. Si një ndër paniret më të mëdha në botë të kësaj fushe, ky panair bashkon ministra dhe shefa të mbrojtjes të shteteve të ndryshme, institucione dhe ekspertë, si dhe audiencë shumë të gjerë të fushës së sigurisë dhe mbrojtjes anë e kënd botës.

RRITJE E SIGURISË NË FUSHËN E MBROJTJES

Bashkëpunimi me kompanitë izraelite në fushën e sigurisë kibernetike


Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, priti në takim 11 gusht, drejtorin izraelit të Marketingut dhe Zhvillimit të Biznesit dhe menaxherit në Divizionin për Siguri Kibernetike pranë "ELTA Systems Ltd.", Roi Shaposhnik, të shoqëruar nga drejtori i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi. Në këtë takim miqësor u bisedua lidhur me fillimin e bashkëpunimit në sferën e shumta në mes të Republikës së Kosovës dhe Izraelit, në veçanti në sferën e trajnimeve në fushën e kibernetikës. Me këtë rast, ministri Mehaj e falënderoi drejtorin Shaposhnik për ofrimin e ndihmës në avancimin e institucioneve të sigurisë, në rritjen e sigurisë dhe sidomos në fushën e mbrojtjes.



Gjeneral Rama dekoroi me medalje atasheun italian të mbrojtjes, kolonel Giuseppe Montalto

Në Ministrinë e Mbrojtjes, më 11 gusht 2021, komandanti i FSK-së, Gjenerallejtënant Rrahman Rama priti në takim lamtumire atasheun jo-rezident italian të mbrojtjes për Kosovën, kolonel Giuseppe Montalto, me rastin e përfundimit të misionit të tij. Me motivacion për ndihmën e jashtëzakonshme dhe vetëmohuese gjatë misionit të tij tre vjeçar, Gjeneral Rama, e dekoroi kolonel Montalto me medaljen për "Shërbim Vetëmohues". Me këtë rast, gjeneral Rama theksoi se vizioni strategjik, udhëheqja dhe përkushtimi i kolonel Montaltos kanë qenë shumë të rëndësishme në zhvillimin e FSK-së. Nga ana e tij, kolonel Montalto falënderoi Gjeneral Ramën për vlerësimin dhe shprehu admirimin e tij për të arriturat e deritashme të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, si dhe për mikpritjen dhe bashkëpunimin gjatë shërbimit të tij.





“Të gjitha kapacitetet e Armatës, potenciali njerëzor dhe avionët tanë ishin të angazhuar dhe ende janë, për të cilët praktikisht nuk kishte hapësirë për pushim në asnjë moment. Janë angazhuar njësitë e këmbësorisë nga Komanda e Operacioneve, më saktësisht Brigada e Parë, forcat speciale dhe pjesëtarët dhe avionët e VING-ut të Forcave Ajrore. Në një fajlë, të gjitha kapacitetet së bashku me logjistikën që kanë njohuri dhe aftësi për t'u marrë me zjarret,” tha ministrja Shekerinska.



Pa kursyer veten dhe pa rezerva, Armata doli për qytetarët dhe vendin e saj

Shekerinska konferencë shtypi për kontributin e Armatës në përballimin e zjarreve

Deri në mëngjesin e datës 11 gusht, 1,614 pjesëtarë të Armatës janë angazhuar në përballimin e zjarreve në të gjithë vendin. Mbi 1.000 ushtarë janë në gatishmëri çdo ditë, dhe mesatarisht 250 deri në 400 ushtarë me pajisje, makineri dhe avionë të plotë janë në dispozicion çdo ditë për të luftuar zjarret. U bënë më shumë se 80 ngritje dhe në mbi 300 fluturime u hodhën më shumë se 650 tonë ujë.

Këto janë numrat për angazhimin e pjesëtarëve të ushtrisë në dhjetë ditët e fundit, pas shpërthimit të një numri të madh zjarresh në territorin tonë.

Ministrja e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska, së bashku me komandantin e Komandës së Operacioneve, gjeneral Besnik Emini dhe komandantin e VING-ut të Forcave Ajrore, kolonel Stojko Pejovski, sot informuan në detaje për përfshirjen e pjesëtarëve të Armatës në përballimin e zjarreve.

“Të gjitha kapacitetet e Armatës, potenciali njerëzor dhe avionët tanë ishin të angazhuar dhe ende janë, për të cilët praktikisht nuk kishte hapësirë për pushim në asnjë moment. Janë angazhuar njësitë e këmbësorisë nga Komanda e Operacioneve, më saktësisht Brigada e Parë, forcat speciale dhe pjesëtarët dhe avionët e VING-ut të Forcave Ajrore. Në një fajlë, të gjitha kapacitetet së bashku me logjistikën që kanë njohuri dhe aftësi për t'u marrë me zjarret,” tha ministrja Shekerinska.

Ministri theksoi se është nder të falënderoj në mënyrë të përsëritur ushtarët personalisht, për angazhimin e tyre dhe për rrezikun me të cilat ballafaqohen si në tokë ashtu edhe në ajër.

“I vizitova ushtarët dhe oficerët tanë në Staro Nagoričan, në rajonin Berovës-Pehçevës, në Prilep dhe në Shtip, sot pata rastin të flas me shu-



micën e pjesëtarëve të VING – Forcave Ajrore. Të gjithë meritojnë notat dhe lavdërimet më të larta se puna që bënë ata ishte vërtet heroike. Asnjëri prej tyre nuk bëri pyetje, asnjëri prej tyre nuk u fsheh, asnjëri prej tyre nuk u largua në pjesën më të vështirë, por të gjithë ishin të pranishëm dhe ishin prezent gjatë gjithë kohës. Me disa oficerë që shihni para jush sot jam dëgjues pothuajse nga ora gjashtë e mëngjesit deri në mesnatë. Ata ishin në punë. Dhe, ata ishin në punë sepse ushtarët dhe pleqtë e tyre ishin në punë. “Mendoj se në momente të tilla unë, si ministre e Mbrojtjes, ndiej nevojën t'i falënderoj të gjithë ata dhe t'u them se as

unë dhe as ky vend nuk do ta harrojmë këtë,” tha ministrja. Ministrja falënderoi si vendet fqinje ashtu edhe aleatët për reagimin e shpejtë – Sllovenia me shpejtësi rrufoje dërgoi ekupe që veprojnë në terren, dhe Rumania në më pak se 24 orë pas kërkesës, vendosi të dërgojë një aeroplan për veprim me kapacitet të madh nga ajri. Sot, Mali i Zi njoftoi se do të dërgojë një helikopter Bell-412 për t'u përfshirë në trajtimin e zjarreve. Falënderimet iu bënë edhe Serbisë, e cila ndihmoi në përpjekjet ajrore, si dhe Austrisë, e cila dërgoi zjarrfikës. “Kjo është vlera në të cilën besojmë si fqinjët tanë ashtu edhe aleatët tanë në NATO. “Së bashku ne mund të

përballojmë më mirë të gjitha këto sfida,” tha ministrja. Lidhur me shkaqet e mundshme të zjarreve, ministrja informoi se në disa raste në bisedat me oficerët dhe ushtarët asaj i janë përcjellë dyshime se një pjesë e shkaqeve të zjarreve ishte faktori njerëzor, pra që ato ishin shkaktuar qëllimisht, duke shtuar se “ushtria mbetet zgjuar dhe qëndron e vendosur në vende të shumta mest tjerash për të parandaluar përshkallëzimin e mëtejshëm. Ne nuk do të lejojmë që asnjë jetë njerëzore të rrezikohet për shkak të një sjelljeje të tillë të papërgjegjshme ose kriminale.”

Komandanti i Komandës së Operacioneve, gjeneral Emini, theksoi se

“shumë ushtarë dhe oficerë tanë, në mënyrë bujare dhe me sakrificë kaluan netët e tyre, duke patrulluar dhe shuar zjarret para fshatrave dhe vendbanimeve tona në Kumanovë, Koçan, Berovë, Dellçevë, Pehçevë dhe Veles.” Emini shprehu mirënjohje publike për të gjithë pjesëtarët e Armatës në shuarjen e zjarreve, për angazhimin, sakrificën dhe guximin e tyre, si dhe shprehu mirënjohje për familjet dhe prindërit e tyre për mbështetjen dhe mirëkuptimin e tyre.

Gjenerali Emini tha se Armata mbetet e vendosur dhe e përkushtuar dhe vazhdon të vërë në dispozicion të gjitha burimet në mënyrë që të shuajnë zjarret dhe të mbrojnë qytetarët.

Kolonel Stojko Pejovski, Komandant i VING-ut të Forcave Ajrore në Armatë informoi për aktivitetet e VING-ut dhe organizimin e të ashtuquajturit “Pozicioni i derdhur” për rimbushje të helikopterëve me karburant në zonën e fshatit Stojmirovo, e cila, siç tha ai, rriti shpejtësinë, efikasitetin dhe sasinë e ujit të shkarkuar në zonat e djegura.

„Temperaturat jashtëzakonisht të larta të ajrit që arrijnë deri në 41 gradë nën hije janë një sfidë e madhe për ne dhe nuk duhet të harrojmë temperaturën mbi zonat e djegura me flakë, ndërsa avioni është pikërisht mbi to. “Sidoqoftë, dinamika e ekzekutimit të detyrave vazhdon me një ritëm të pazvogëluar,” tha koloneli Pejovski.

Avioni luftarak rumun me kapacitet të lartë C-27 Spartan iu bashkohet zjarrfikësve

Avioni C-27 Spartan i Forcave Ajrore rumune, i specializuar në shuarjen e zjarrit dhe ka një kapacitet të veprojë me 6 tonë ujë mbi zjarre, ka mbërritur në vend dhe mund të fillojë menjëherë një operacion zjarrfikës. Avioni do të operojë në rajonin e Berovës. (7 gusht)

Një avion tjetër rumun pritet të mbërrijë së shpejti për të sjellë kontejnerë dhe pajisje shtesë për të mbështetur shuarjen e zjarrit.

Mbështetja nga aleati ynë në NATO, Rumania, në përballimin e zjarret erdhi me kërkesë të ministres Shekerinska ndaj homologut të saj rumun, Nikolae Jonel Çuka, për ndihmë emergjente në përballimin e zjarreve.

„Ju lutemi përcaktoni mundësitë për dërgimin e një aeroplani për t'u



marrë me zjarret në pyje, të cilat janë me nevojë të jashtëzakonshme për Republikën e Maqedonisë së Veriut.” “Solidariteti aleat është shumë i rëndësishëm në këto kohë të vështira dhe ne

jemi mirënjohës për të gjithë ndihmën dhe mbështetjen tuaj,” thuhet në letrën dërguar nga ministrja Shekerinska për ministrin rumun të Mbrojtjes Kombëtare Nikolae Jonel Çuka.



1500 pjesëtarët e Armatës u përfshinë në shuarjen e zjarreve nga toka dhe nga ajri

Në dhjetë ditët e fundit që nga shpërthimi i zjarreve, 1,500 pjesëtarë të Armatës janë përfshirë në përballjen me stuhinë e zjarrit.

Informacione të detajuara mbi angazhimin e pjesëtarëve të ushtrisë nga toka dhe ajri, u shpallën në 11 gusht në një konferencë për shtyp në Qendrën e Trajnimit të Pilotëve, kazerma “Strasho Pinxhur” – Petrovec. Konferenca për shtyp në ora 13 pasdite e datës 11 gusht nga ministrja e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska, gjeneral brigade Besnik Emini, komandanti i Komandës së Operacioneve të Armatës dhe kolonel Stojko Pejovski, komandant i VING të Forcave Ajrore, shpalosi arritjet.

Udhëtim në kohë i familjes Binaj



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Fytyra është një muze

Libri "Familja ime, një udhëtim në kohë" i autorëve ushtarakë Prof. Dr. Agim Binaj dhe Dr. Ilir Binaj ka dalë së fundi nga botimi. Libri, shprehur autorët në parathënie, është udhëtim i familjes Binaj, duke nisur që nga regjistrimet civile, analizën e ADN-së, tregime në familje, këngëve të përcjella në breza dhe të dokumenteve historike. Nëpërmjet këtij libri autorët i kanë dhënë lexuesit dhe brezave të ardhshëm të familjes Binaj udhëtimin në kohë, duke marrë shumë vite kohë për të realizuar një punim të tillë. Ndërsa kujtimet e Jonuz Zeqir Binaj të shkruara në verën e vitit 1989, ndërtauan rrugëtimin e këtij libri duke përfshirë pemën familjare, studime gjenetike, arkivore dhe historike. Autorët theksojnë se fytyra është një muze, sepse ajo ka tipare të trashëguara nga prindërit, gjyshërit, stërgjyshërit e më tej, cilësi komplekse si sensi i balancës, muzikaliteti, rezistenca ndaj sëmundjeve etj. Kështu e shkuara gjithmonë gjendet në trupin tonë, në tradita dhe zakone.

Libri ju shërben kërkuesve të gjenealogjisë, amatorëve dhe profesionistëve, për paraardhësit e tyre, por edhe për kërkimin e linjave familjare të lidhura me familjen Binaj. Në libër gjendet një informacion i bollshëm për kohë të ndryshme të krahinës së Labërisë, ku përfshihet dhe zona e Kudhës Gerhot, me malet, zakonet, folklorin, veshjen dhe ushqimin etj. Libri ka një strukturë të thjeshtë i ndërtaur me shtatë kapituj që trajtojnë histori familjare sipas kujtimeve të Jonuz Binaj, në kërkim të origjinës, studimi i prejardhjes gjenetike, patriotët dhe ushtarë, histori dhe emocione të përcjella në këngë, veshje tradicionale, zakone familjare dhe ritet fetare, shtëpia, kuzhina dhe receta familjare.

Lindja dhe zhvillimi i fisit

Duke u bazuar në kujtimet e Jonuz Zeqir Binaj, të marra nga Agim Binaj në gusht të vitit 1989, rreth shek. XIV-XV (midis viteve 1400-1500) në rrëzë të malit të Tartarit, në Sevasterin e sotëm, vendosen dy vëllezër me familjet e tyre. Ata ishin Qopi dhe Xhaku të cilët ishin zhvendosur në këtë trevë. Gojëdhëna thotë se ata vinin nga fshati Kudhës i Bregdetit, por nuk ka të dhëna të sakta. Thuhet se kanë ardhur për arsye hasmërie. Këtu dy vëllezërit e ardhur kanë gjetur vendas si Marko Krahi, ku sot është një mëhallë Markaj në fshatin Sevaster. Në fshatin Sevaster ka dhe mëhalla si Maricaj, Rrokaj, Rustemaj, Gockaj, Shehajt, Pecaj, Zhupaj, Kokaj, Haxhirajt. Sevasteri aktualisht përbëhet prej 12 mëhallëve, që kanë dhe 12 çezma, për secilin mëhallë.

Në Sevaster kanë qenë dy mëhalla të forta e të mëdha dhe këto kanë luajtur rolin e udhëheqës së fshatit ose të parisë së tij. Sevasteri i sotëm (një fshat i krahinës së Kudhës) ka pasur parinë e vet që përbëhej nga një pjesëtar për çdo mëhallë, pra të 12 mëhallët kishin 12 pjesëtarë. Këta çdo të premtë mblihdeshin në kuvend të Rrapi i Lelos, poshtë fshatit, në krye të fushës, buzë Vjosës, në veri të fshatit Golimbas. Krahina e Kudhës përbëhej nga gjashtë fshatra, që janë Sevasteri, Shkoza, Golimbasi, Ploça, Dushkaraku dhe Mazhari. Kryesor ishte fshati Sevaster, si fshati më i madh me 300 shtëpi. Për secilin fshat kishte në krye



një plak që dhe ai ishte pjesëtar i kuvendit. Ky kuvend diskutonte për të gjitha ngjarjet që ndodhnin në krahinë si për të mirat që ishin bërë ashtu edhe të këqijat. Kuvendi qoftë për mirë, qoftë për keq rrinte gjithnjë grup. Kudhësi është dalluar për trimëri, për unitet të fshatrave njeri me tjetrin, në luftën kundër fshatrave të tjerë. Në kohën e Vlorës katër fshatra kanë qenë dëgjuar: Kudhësi, Smokthina, Kanina dhe Dukati. Për nevojat e mbrojtjes nga sulmet e krahinave të tjera, që mund të ishin nga Myzeqeja nga Skrapari, apo dhe nga Veriu i Shqipërisë, krahina e Kudhësit ndërtoi një kala të fortë në buzë të Vjosës. Kënga popullore e ka përjetësuar: O Kudhësiot pishqolla larë./ Ku i shpini katër trarë./ Në fushë do të ngremë kalanë./ Me urdhër nga krerët tanë. Në këtë kre trajtohen mjaft probleme si grindjet për kullotat malore, Peta, një vrasje në mëhallën Qopr, një ngjarje tjetër në kohën e Ali Pashë Tepelenës, nusja nga Salara, shkolla dhe feja, ekonomia e Kudhësit, fisi Qopi dhe zmadhimi i tij, Bino Shakua, Ismail Binua dhe ngjarje të tjera në kohë...

Lidhja me lëvizjen në shkurt 1942

Kujtimet vazhdojnë... Ndërkohë në fshat filloi të ndihej ndikimi i Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare (LANÇ) dhe të ideve komuniste. Nga fillimi i janarit të vitit 1943 u zhvillua Lufta e Gjormit ku erdhën shumë mercenarë nga veriu me Halil Alinë dhe bënë shumë dëme e vranë njerëz të pafajshëm. Nga fisi Binaj për të luftuar italianët në Gjorm, vajti Laver Binaj bashkë me shumë vullnetarë të tjerë. U bë luftë e madhe. Aty u vra edhe komandanti italian. Ndërsa në maj 1943 vazhdon kujtimet Jonuz Zeqir Binaj, u lidha përfundimisht me Lëvizjen e dola ilegal. U përfshiva me forcat territoriale me të cilat më vonë u krijua



batalioni territorial i krahinës së Kudhësit ku bënë pjesë rreth 100 e ca vetë. Unë u caktova skuadërkomandant. Shaqo Delo ishte komandant i Batalionit Territorial. Forcat territoriale bashke me çetën partizane "Kanan Maze" vepronin gjatë rrugës automobilistike Tepelenë-Vlorë.

"Batalioni territorial i Kudhësit u grumbullua pranë fshatit Amonicë në një pyll. Pjesë e këtij batalioni u bënë edhe çetat "Kanan Maze", "Plakë" dhe "Zigur Lelo". U nisëm për në Sklap të Mavrovës. Kërkova leje te Shaqo Delo, sepse kisha gjysmën e misrit pa korrë. Mirë më tha, por do të lësh dyfekun. I thashë se "dyfekun nuk e lë, po me lë me gjithë dyfek mirë, po s'më le nuk do iki, dyfekun se lëshoj nga dora". Ik me tha me gjithë dyfek. Dëgjova natën të shtëna, Batalioni ra në luftë me italianët. Lashë misrin dhe ika në luftë në Mavrovë. Erdhi dhe Veipi deri në Qafë të Mallkeqit. I thashë ktheu se ishte i vogël rreth 15 vjeç. E binda dhe u kthye. Në Mallkeq bëra alarm, doli vetëm vëllai i Selam Mexhitit. Të dy shkua në Sklap të Mavrovës, lufta vazhdohte. U futëm në pozicion dhe fillova të luftoja." Lidhja e Jonuz Binaj me LANÇ-in ka ndodhur nëpërmjet Skënder Velos që ishte edhe drejtuesi kryesor i lëvizjes në Sevaster. Fshati i Sevasterit kishte anuar nga LANÇ-i që në dhjetor 1941, si pasojë e ndërhyrjes dhe influencës së Ibrahim Dervishit nga Kanina, përfaqësues i PKSH, që ditën e faljes së Bajramit i kishte bindur sevasteriotët të betoheshin për të bashkuar me LANÇ-in.

Në kërkim të origjinës

Ky është një kapitull tepër interesant dhe mjaft i domosdoshëm. Autorët kanë arritur të bëjnë një rishikim kronologjik të ngjarjeve historike që kanë ndikuar në krahinën e Kudhësit dhe më gjërë, në Labëri dhe Shqipëri, i kujtimeve të ndryshme të udhëtarëve të huaj, si edhe i regjistrave kadastrale të disponueshëm deri në krijimin e shtetit Shqiptar, në vitin 1912. Krahina e Kudhës-Gerhotit, me një gjatësi rreth 30 km dhe një gjerësi rreth 10 km, shtrihet buzë Vjosës faqes së Malit të Tartarit ose Malit të Bardhë. Zona ka një histori antike, pasi ndodhet pranë qytetit të lashtë Amantia.

Origjina e emrit Sevaster lidhet me atë të një qeveritari Bizantin të nivelit të lartë (Sevastokrator), që rrinte në kështjellën apo kullën e Ploçës, në Amantia, pranë Kudhësit, tri orë larg nga qyteti i Vlorës. Sevastokrator është një titull që u krijua nga perandori bizantin Alexios I Komnenos (1081-1118 e.s.) për të nderuar vëllain e tij më të madh Isaac Komnenos. Sevastokrator do të thotë "Crator" - sundues i nderuar dhe i adhuruar-"sebastos", ekuivalenti grek i Augustus-it të Latinëve. Ky titull, fillimisht u jepej anëtarëve të familjes perandorake,

por, më vonë, pas krijimit të titullit "despot" filloi t'iu jepej, në disa raste, edhe dinjitarëve të lartë që nuk ishin anëtarë të familjes perandorake. Ky titull honorifik u përdor, më pas, edhe nga bullgarët e serbët. Deri tani nuk janë gjetur të dhëna se cili Sevastokrator ka qenë në Sevaster dhe, kur ky emër është përdorur për herë të parë, por mesa duket pas vitit 1118 p.e.s.

Qyteti antik Amantia

Sevasteri dhe zona e Kudhës-Gerhotit ka qenë e populluar që në kohët antike nga Amantët. Qyteti antik i Amantias shtrihet në hyrje të luginës së Shushicës, në juglindje të Vlorës, midis kodrave që shtrihen në këmbët e malit të Kudhësit, mbi një kreshhtë 613 m mbi nivelin e detit, ku janë të shpërndara shtëpitë e fshatit Ploçë, ruhen rrënojat e Amantisë. Emri Amantias u përmend për herë të parë në shek. IV p.e.s. Amantia u themelua në fund të shek. V p.e.s. Gërmimet arkeologjike kanë mundur të sjellin në dritë të dhëna historike mbi ekzistencën e Amantisë. Cikli i shekujve ruante një qytetërim të tërë, por i mbetur tashmë si rrënoja, ku dallohen gjurmët e Stadiumit, të akropolit, tempullit dhe mureve mbështetëse. Monumentet, si vepra të mëdha arkitekturore, shprehin rëndësinë dhe, njëkohësisht, mbeten dëshmi e ekzistencës së një qytetërimi të rëndësishëm në Ilirinë Jugore. Amantia u zhvillua si qytet në kodrën e lartë dhe në terracat e saj. Në kohët e lashta, pllaja e sipërme e kodrës ishte e rrethuar me mure fortifikimi. Qyteti u zhvillua jashtë këtyre mureve, përreth Akropolit. Kjo ka bërë që Amantia të mos kish pamjen e qyteteve të tjera ilire për nga ndikimi helen. Godinat dhe banesat e tjera u ngritën në sheshet dhe terracat e mëdha, të zgjeruara dhe të përforcuara me mure në anët e ndryshme të kodrës. Ajo lidhet me luginat e lumenjve Vjosa dhe Shushica dhe me rrugët e lashta që kalonin nëpër to. Ky pozicion bëri që Amantia të shndërrohet në një nyje të rëndësishme në marrëdhëniet tregtare midis bregdetit jugor të Ilirisë dhe krahinave të tij të brendshme. Stadiumi antik është monumenti më i ruajtur, i ndodhur rreth 150 m jashtë mureve.

Patriotë dhe ushtarë

Kudhësi si pjesë e krahinës së Labërisë ka një traditë luftarake të spikatur. Organizimi ushtarak i krahinës bëhej sipas Kanunit të Labërisë (shartet e Idriz Sulit). Banorët e kësaj treve kanë qenë shumë të lidhur me armët, aq sa pa frikë mund të shpreheshim, se ata qenë të dashuruar mbas tyre. Një autor i shek. XVIII, shprehet se banorët e kësaj zone janë gati të vdesin urie për të kursyer paratë për të blerë armë, disa nga fiset e tyre nuk i lënë mënjane armët e veta, madje edhe kur flenë. Këto armë kudhësiotët i blinin me para, e pakta që kishin dhe për të realizuar dëshirën e tyre u drejttoheshin tregtarëve vendas që kishin lidhje me tregjet e Venedikut, dhe atij të Korfuzit. Pamjet e luftëtarëve të kësaj zone sipas udhëtarëve të huaj ishin më të vërtetë mahnitëse, dhe mjaftonte vetëm pamja e veshjes së tyre që t'i bënte presion armikut. Për këtë pamje të këtyre luftëtarëve na jep përshkrimet e tij Pouqueville dhe Lear, por edhe udhëtarë të tjerë që kanë vizituar këtë krahinë, gjatë shek. XIX. Sipas tyre këta luftëtarë mbanin në sup një pushkë të gjatë, në brez një pisqollë e një jatagan dhe në anën e djathtë i varej një thikë me majë të harkuar. Në kokë mbanin një kësulë të vogël me ngjyrë të kuqe, në trup një këmishë të bardhë me mëngë të gjata dhe mbi të një jelek të qëndisur, po kështu vishnin edhe një fustanellë të shkurtër, të cilën e shtrëngonin për mesi me një brez

të gjatë leshi, mbathte tirqe dhe zhapa, të cilat bëheshin prej lëkurëve të lopëve. Po kështu veshja e përhershme e tyre ishte gjithmonë guna, të cilën nuk e ndanin nga vetja edhe në stinën e verës, gunën ata e hidhnin mbi supe, por më shumë si modë e përhapur ajo varej vetëm në njërin sup, gjithmonë në krahun e djathtë, të hedhur në mënyrë të pa kujdesshme. Sikurse tregohet edhe në pikturën e Joseph Cartwright të vitit 1822 për një nga luftëtarët e Ali Pashë Tepelenës në Janinë.

Këta luftëtarë, përgjithësisht në kohë paqe merreshin me blegtori, për ta puna në bujqësi nuk ishte e pëlqyeshme kështu që me punimin e tokës së pakët që ka kjo krahinë malore merreshin përgjithësisht gratë. Por vetëm puna në blegtori me sa duket rezultonte e pamjaftueshme për të mbajtur familjet prandaj ata shpesh herë pajtoheshin si ushtarë me pagesë. Ky lloj profesioni ka qenë shumë i përhapur për banorët e kësaj krahine. Pikërisht nga të rinjtë e kësaj zone mbusheshin radhët e reparteve ushtarake të mbretërve të Spanjës, të Napolit, Republikës së Venedikut, Francës, Turqisë, etj. Shumë nga këta ushtarë kanë pasur edhe karrierë ushtarake në këto vende. Po ju njoh me disa nga ushtarakët e fisit Binaj.

Luftëtari Jonuz Zeqir Binaj mori pjesë në Luftën e Dytë Botërore, si partizan me Frontin Antifashist Nacionalçlirimtar. Ai ishte pjesë në luftimet e bëra në Drashovicë kundër gjermanëve më 14 shtator 1943 dhe në luftimet për çlirimin e Sarandës së bashku me komandot britanike më 9 tetor 1944. Mbas çlirimit të vendit shërbeu në Korçë deri në vitin 1946 në Ushtrinë Kombëtare shqiptare me gradën e togerit. Më pas u lirua nga ushtria dhe u kthye në Sevaster, Vlorë pranë familjes. Në vitin 1979 vendoset në Kotë të Lumit të Vlorës ku qëndroi deri në fund të jetës së tij. Vdiq në moshën 93 vjeç, duke lënë pas vlerën e një burri të urtë, të dashur dhe me zemër të madhe. Këshilltari Elam Aben Binaj mori pjesë në Luftën e Dytë Botërore si partizan në batalionin territorial të Kudhësit, në vitet 1943-1944. Kreu detyrën e sekretarit të Këshillit Nacionalçlirimtar në Sevaster, nga nëntori i vitit 1942.

Ushtaraku marinar Manxhar Nebi Binaj mori pjesë në LANÇ si pjesë e grupit të të rinjve të Sevasterit. Pas çlirimit të vendit kreu Shkolllën e Bashkuar të Oficerëve në vitin 1950 dhe emërohet oficer në Vlorë në Regjimentin e Marinës Bregdetare. Më vonë kreu Akademinë e Lartë Ushtarake në Moskë, në vitet 1955-1959. Në vitin 1967, emërohet zëvendës-komisar i Korpusit në Shkodër. Në vitin 1970 u lirua nga ushtria dhe kaloi në drejtimin e Komitetit Ekzekutiv në Vlorë, më pas sekretar i dytë dhe sekretar i parë në Tepelenë dhe në Gjirokastër. Ishte deputet i Kuvendit të Shqipërisë në vitet 1988-1992. Është nderuar me titullin "Qytetar Nderi" i qytetit të Tepelenës. Ka shkruar dhe botuar libra për Sevasterin dhe Kudhësin. Libri vijon me kapituj për këngën, veshjen, shtëpitë etj., si dhe është i pajisur me foto të ndryshme, tabela, referenca si dhe shtojca për defterin e Sanxhakut të Vlorës të vitit 1583, pema gjenealogjike e Fisit Binaj, certifikata familjare dhe pema filogjenetike. Libri është udhëtim në kohë, por që përcjell mesazhe historike të një fisi, por edhe të një krahine të madhe si Kudhësi. Autorët ushtarakë Agim Binaj dhe Ilir Binaj (oficer policie Në Bruklin, SHBA) kanë bërë një prezantim ndryshe të historisë familjare nëpërmjet kujtimeve të më të moçmit të familjes Binaj.



EMERGJENCAT

Vijon puna e FA dhe autoriteteve lokale për shuarjen e zjarreve

Forcat e Armatosura dhe zjarrfikësit lokalë kanë vënë nën kontroll zjarrin në Malin e Rrjacës në Prrenjas, por puna vijon pasi era mund ta favorizojë duke rrezikuar Parkun Kombëtar të Shebenik-Jabllanicës në kufi me Maqedoninë e Veriut, ku edhe fqinjët tanë po punojnë në pjesën e tyre. Mbi 100 forca po luftojnë me flakët në 2 vatra të ndryshme në fshatrat Thirrë dhe Katund i Vjetër në Mirditë, ku tymi i dendur ka vështirësuar ndërhyrjen nga ajri dhe era favorizon flakët. Në malin e Tërbunit në Pukë dhe fshatin Dardhë në Fushë-Arrëz era dhe terreni po favorizojnë përhapjen e zjarrit, ndërkohë që në këto 2 vatra po punojnë aktualisht në terren rreth 200 forca. Vatrat e tjera në vend nuk paraqesin rrezik të lartë dhe vijon puna e autoriteteve lokale për shuarjen e tyre.

